

VASIL ALARUPI

# RIVOLUCIONI FASHIST



BOTIMET BRERORE

VASIL ALARUPI

RIVOLUCIONI

FASHIST

Mblodhi e përpunoi: Juxhin Halo, Eugen Lilo

© Botimet Brerore

[brerore@outlook.com](mailto:brerore@outlook.com)

2021



VASIL DHIMTËR ALARUPI

# INTERVENTIZMI

Jeta e Benito Mussolini-t është e tëra: vullnet, veprim, luftim: ngritje përhera lart e personit dhe e gjenit. U këthye nga Svicera ku njojt se çdomethënë puna e rëndë, duart plot kallo, nga përdorimi i kazmës dhe i lopatës: por edhe ku dijt të studjojë, gjatë orëve të vona të natës, mjerisht gjumit, për të pajisur mëndjen me kulturën e lartër. Ishte një jetë punëtori dhe studenti.

Më vonë shkoi edhe në Trento, ku u-njojt dhe bashkëpunoi me martirin fashist Cesare Battisti. Por edhe Austria e gjeti të pa-dëshëruarshme ndodhjen e tij në tokën e saj. Rikëthehet edhe këtë herë në vëndin e vetë. “Vendimi i dbimit për neve është një humbje e madhe, po për atë është një lavdi” shkruante Battisti. Tani ky atë, i ri akoma, nuk do të jetë për një kohë të shkurtë, veç se një “profet i vogël lokal”, dhe sekretar i Federatës socialiste të Forli-t, me një rrogë muajore prej 120 liretash.

Në mbarimin e luftës së Libisë, Mussolini ngrihet në radhët e para të socializmit italian dhe arrin drejtor i organit zyrtar të partisë, fletores “Avanti!”. Shtyllat e kësaj gazete do të bëhen shpejt, tribuna e tij e përditëshme.

Kalon koha.

Por edhe duke milituar në radhët e socializmit italian, Mussolini, mendon e vepron që tani si një fashist. Të pestë muajt burgimi që i shkakëtuan turbullimet e Forli-t e vunë në dukje të madhe dhe përpara gjykatores, që e dënoi si drejtor të fletores për një artikull të rreptë, u-mbrojt vetë, mbrojt veprimin e tij si dhe bashkëpunëtorët redaktore me një fjalim aq’ elokuent n’ashpërsin e tij të hekurt, sa të na përmëndë oratorët e kohëve të moçme. U-vu re n’atë gjyq, një stil i ri elokuce, goditës e i shkathët, stil që më

vonë do të kalonte n'histori me emërin “oratoria mussoliniane”

Q'atëhere, shquhej nga socialistët si një socialist i “veçantë”, që gjukonte në një mënyrë krejt personale, që fliste aqë mprehtësisht dhe që ish aqë tmerërisht i përpiktë në gjërat që godiste, të cilat çbërtheheshin e shkriheshin krejt.

Kish kundër tij opozitën e shurdhër të shumicës, e sidomos të disave që, qysh atëhere kishin mundur të lëçitnin, qartazi, në thellësin e shpirtit të tij. “Ay s'është marxist për asnjë grosh”, theshin.

Si në fletoren që drejtonte dhe nëpër kongreset, me anë të pendës e të elokuencës, ishte treguar “diçka tjetër” që s'i ngjiste aspak një socialisti.

A s'u-kish thirur socialistëve të heqin dorë nga kështjellat ëndarrake? A s'u-kish thirur katundarëve t'Italisë së mesme, gjaku i të cilëve ridhte përhera nëpër goditje të turbullta, të kërkojnë paga, banesa, dritë nëpër shtëpit'e erëta, udhë për të ndërtuar?

“Populli, do të thotë ay më 1924, sa herë që e kam hasur nuk më ka kërkuar t'a çliroj nga një tirani q'y nuk ndjen fare, me q'ajo nuk gjendet aspak: më ka kërkuar përkundrazi, udhë-hekuri, shtëpi, urrëra, ujë, dritë dhe udhë”.

Neve sot, këto i shohim krejtësisht të realizuara nga Shteti fashist, për mirëqënien dhe dobin e popullit punëtor.

Sikundër për jetën e një njeriu dhe për gjithshka që gjendet në natyrë, që i bindet një vullneti dinamik, një qëllimi të brëndëshmë, ashtu edhe popujt s'ka gjë në këtë botë që t'i ndalë në hovin e tyre, kur arrin çasti i cili

gjykohet i përshtatëshme për të vepëruar e për të ndjekur fatin e vetë.

Historia e Evropës kishte arritur pikërisht këtë gjendje: rivolucion apo luftë. Mussolini u-radhit nga ana e luftës. N' historin e botës, lufta shpesh herë, paraqitet si një nevojë e domosdoshme, sepse gjenden përhera, midis kombeve, shkake kundërshtimi që, në pamundësi të zgjidhen në mënyrë paqësore, duhen zgjidhur me anë të armëvevet.

Ngjarjet n' atë kohë, po ridhnin me shpejtësi. Gjendemi në prakun e luftës së përbotëshme. Ndërhyrja e Italisë çfaqej e domosdoshme; ishte kjo një çeshtje jete ose vdekjeje. Por Italia nuk ishte e përgatitur as moralisht as ushtarakisht. Drejtonjësit e atëherëshme, qenë njerëz të kllanikut, njerëz të pallavrave utopike, njerëz që ngadalësia i katandiste frikamanë.

Disave, pasuria personale u-dhimbesh më shumë se koka e Atdheut dhe tmeroheshin nga frika të humbasin pasurinë personale në rrezikun e luftës. Socializmi, shtynte shumicat e punëtorëve të ngrihen kundra Atdheut. Të gjitha më kot.

Populli q' i kish damarët e fortë, ay popull që zbriste drejt për së drejti nga gjiri i Romës së Amëshuarë, e mblodhi vehten. Dhe kur tingëlloi zëri i bukur n' Orën e Madhe të fatit, ay diji të bashkohet dhe t' i përgjigjet njëzëri thirjes s' Atdheut. Mizëria të rinjsh, të kapur për krahu, përshkonin rrugët, me këng' e me brohoritje, intelektualë e punëtorë të bashkuar, gati të hidhen në fushën e betejës në thirjen më të parë.

Atdheu pra, ishte një tërësi e vërtetë, madhështore, prandaj edhe ndërhyrja e nevojshme. Po, kur këta të rinj, gati me një herë të japin jetën e tyre në fushat e betejës,

grumbulloheshin nëpër sheshet duke kënduar e duke kërkuar luftën, politikaxhinjt e plakur, të raskapitur nga ideologjit e vjetëruara, bënin tuxharllëke. Q'atëhere filloi ngrysjja e botës së tyre.

Edhe nga këndet më të largët të botës, rodhë m'Atdhe, me mijëra bij të tij, të luftojnë për “nderin” e fisit.

Proletariati, kishte qënë i hequr për hunde nga njerëzit që e drejtonin; këta idenë e revolucionit e kishin katandisur në një zanat të këndëshme për veten e tyre. Kufizoheshin të bërtasin “formulat” teorike, të mësuara përmëndsh dhe luftës nuk deshën t'i a dëgjonin as namin as faninë me qënë se ajo ish në kundërshtim me teorit e tyre doktrinale, pa sa pare bënte, nëse ata predikonin, një tjetër lloj luftime, që quhej lufta e klasave! Por ishte meseleja të mos humbisnin ofiqet e privilegjet nga të cilat qënë mësuar të jetojnë “urt'e butë e tiganë plot”

Mussolini, Corridoni, D'Annunzio e një grusht tjetër shokësh besnikë, jetën e tyre e quanin si një mision therorie dhe luftimi, vetëm këta e kuptuan se lufta do t'ish për Italinë, fillimi i një revolucionit madhështor, fakt i vërtetë, i vërtetë përmbi “vërtetësit” që shpallnin doktrinën politike, të cilat, tanimë, dukeshin në mungesë të krejtë themelesh.

Mussolini u'a braktisi drejtimin e fletores socialiste, socialistëve, së bashku me rrogën e tij të fundit. Ata, pastaj e dbuan edhe nga partija. Por, pas ca ditës, ay, me sakrificat të mbëdha, mbi një tryezë ordinare, me një dy kareklla rrotull, me disa shokë besnikë, themeloi një fletore tjetër. Ishte pikërisht më 15 nëndor 1914 që dolli numuri i parë i gazetës “Il Popolo d'Italia” e përditëshme socialiste dhe me dy fraza poshte titullit: “Kush ka hekur ka bukë” si dhe

tjetra: “Rivolucioni është një ide që ka gjetur bajoneta për t’u-mbrojtur”. Titulli i kryeartikullit të parë të firmuar: Mussolini, ishte “Audacia”, Guxim. Ishte një artikull që i drejtohej të rinjve: “I drejtohem djalërisë s’Italisë. Djalërisë së fabrikave dhe të shkollave. U-drejtohem të gjith atyre që kanë mbajtur shpirtin e ri. U-drejtohem të gjith atyre që fati i ka ngarkuar të bëjnë historinë. Le t’a dëgjojnë thirjen t’ime.”

“Është një fjalë që nuk do t’a kisha thënë në kohëra normale dhe që e them, përkundrazi sot, me një zë të qartë, me një besim të sigurt. Një fjalë e tmerëshme dhe përfshinjëse: luftë!”

Dhe për t’a mbrojtur e forcuar çështjen e ndërhyrjes krioi Fashet e veprimit, prekursorë të Fasheve të Luftimit.

Kundërshtarët e ndërhyrjes, politikaxhinjt e ideve të ngrysurat, e sulmuan Mussolini-n pa reshtur, por ay që i bindur tanimë se “Parllamenti ishte çibani që helmonte Italinë” dhe u bëri ballë me veprimin e tij të jashtzakonëshme.

Erdhë pastaj, ditët e shkëlqyera të majit kur populli e Mbreti vepruan armonikisht, Lufta u shpall. “Sot Kombi është i thirur nën armë. Nuk ka më veçse Italianë. Një zë i vetëm burron nga zemrat t’ona: Rroftë Italia! Kurrë, më mirë se në këtë çast, nuk e kemi ndjerë se Atdheu gjendet, se është një gjë e pashuajturshme nga ndërgjegjeja njerëzore. Kurrë s’e kemi pasur, si në këtë fillim lufte, ndjenjën, se Italia ish një qenie historike, e gjallë, e vërtetë, e pavdekëshme. Të dhurojmë o Atdhe, jetën t’one dhe vdekjen t’onë!”

Kështu shkruante Mussolini atë ditën e 24 majit 1915.



E disa ditë më parë nga kjo datë një artikullin e tij e mbaronte në këtë mënyrë: “Bajoneta italiane: fati i Italisë dhe ay i Evropës i është besuar çelnikut t’uaj”.

Me njëherë pas shpalljes së luftës, Mussolini me shokët e tij besnikë, shkoi vullnetar, bersaglier i thjeshtë, shërbenjës i Atdheut sikundër në kohën e paqes, edhe në kohën e luftës, po me atë hov e me atë flakë. Shëmbëll kryetari të Madh e të denjë, shëmbëll që e ka vënë në zbatim përhera. Profecia e Tij, u vërtetua, se ishte vlera e ushtëris Italiane, që në Vittorio Veneto, e kurorëzoi Kryen e Atdheut me kurrorën e lavdisë.

## THEMELIMI I FASHIOVE ITALIANE TË LUFTIMIT

Nuk është e mundur, – për ngushticë vëndi – të përmëdim ato faqet që janë dokumenta të shkëlqyera, të shkrojtura nga Duce-ja në ditorin e tij të luftës. Janë faqe historike të shënuara nëpër llogoret tërë baltë, përballë armikut, nën plasjen e bombave, nën breshërin e plumbave, nën zhurmën e aeroplanëve armikë që fluturojnë mbi kokë, që kanosin ushtarin me rrezikun e jetës. Janë dëshmira të mrekulluarshme t’heroizmit t’ushtarit italian; janë faqe të shkrojtura nga një karakter plot vuxhut, dëndur të përmbledhura në shënime të shpejta, sepse, ay q’i ka shkrojtur, ka qënë i ndërprerë nga veprime ushtarake të papritur kundra armikut, ose nga plasjet rotull tij, të gjylëve që shtinin topat e kundërshtarit.

“Morali i ushtarëve italianë është i mirë: ushtarët italianë janë të dishiplinuar, plot kurrajë, plot vullnet. Kush di t’u-sillet, duke i konsideruar si të zotët për gjykim

dhe jo si numura matrikulli: me ata ushtarë mund t'arrijet çdo rezultat i dëshëruar; që nga puna e mërzitur e angarive, gjer në sulmin e vrullshëm dhe vdekjeprurës të bajonetave”.

Fytyra e ushtarit italian, na çfaqet e gjallë në lëçitjen e këtyre pak radhëve. Ne e dimë fort bukur dhe të gjithë bota e di sot, se ç' domethënë dishiplina e hekurt fashiste e Ushtëris së lavdishme italiane.

Vetë Duçe-ja, luftoi trimërisht që në fillim të luftës e gjer në gushtin e vitit 1917, datë kur u plagos rëndë në ballin e zjarrit.

Në Spitalin ku ishte shtruar për mjekim, Duçe-ja pati nderin e lartër të vizitohet edhe nga vetë Madhëri e Tij Mbreti.

Duçe-ja, duke dhënë i pari shëmbëllën e Kryetarit me të vërtetë të Madh e të denjë, shkoi, siç e dimë, bashkë me shokët e tij besnikë, vullnetar në ballin e luftës. Shokëve të punës që mbetnë, u-la drejtimet për të vazhduar përpjekjet si dhe programin që përmbli dhej në këto fjalë: “mos u çarmatosni”, se duhej luftuar brënda vëndit, sikundër luftohej në front. Duhej vazhduar lufta edhe kundra armikëve të brëndëshme, kundra marxistëve mohonjësve t'Atdheut.

Interventistët, shokët besnikë të Mussolini-t, e paguan ndërhyrjen heroike me gjakun e vetë. Shumë prej tyre, ranë në fushën e nderit, si ç' ra Corridoni në llogoret e Franche-s dhe sa e sa të tjerë që u-bënë shëmbëll heroizmi për popullin e madh italian.

Kujtohet Gabriele D' Annunzio, poeti ushtar, “Komandanti”, si ç'e thërisnin, që me fjalimet e tij të zjarrtë u-a kishte hequr maskën deputetëve asnjans në orën më të dobët të tuxharllëkut të tyre. Komandanti luftoi

në luftë sa kohë zgjati lufta. Kujtohen fluturimet e tij të guximshëm që bëri mbi tokën armike.

Kujtohet heroizma e Costanzo Ciano-s, në Buccari. Lista do t' ishte tepër e gjatë për t' a cituar tërësisht. Por sa e sa prej tyre që, të rënë robër në duart e armikut, u-vranë tmerërisht, e tani kanë lënë emërat që figurojnë në listën e lavdishme të martirëve t' Atdheut.

Pas Fitorjes së madhe italiane në Vittorio Veneto, më 4 nëndor 1918 lufta e përbotëshme merte fund. Ushtria italiane që kish lënë në fushat e lavdisë 670,000 të vranë dhe që këthehej tani e mburëshme me 400,000 të cinguar dhe një milion të plagosur, rifillonte jetën e saj qytetare.

Po mjerisht kësaj sakrifice kollosale, Aleatët, pas armëpushimit, në tryezën e çalë të Versailles, shpërblyen më shumë e më mirë kombet që kishin luftuar më pak e që kishin bërë sakrifica shumë të vogla. Italisë i'a mohuan më të shumtat e fruteve të fitorjes së saj. Edhe ato që i premtuan, nuk i'a dhanë.

Posa kish mbaruar lufta. Italia filloi të kalojë një periudhë me të vërtet të dhimbëshme, një periudhë në të cilën neutralistët më të dobët, po ata neutralistë kundër të cilëve Mussolini kish luftuar në kohën e interventizmit më 1915, filluan të shkakëtojnë turbullime nëpër rrugët e nëpër sheshet, pasi kishin qëndruar të tulitur si pulat, gjatë kohës së luftës, në një heshtje frikacakësh, duke punuar nën rogoz e duke mbjellë dëshprime.

Mussolini posa kish braktisur patericat me të cilat ecte, pas plagosjes në luftë dhe me t'u-shëruar, u-ngrit kundra tembellëkut dhe poshtërsisë. ç'fuqi e ç'vullnet të jashtzakonshim i-u deshnë për t' u-bërë ballë sulmeve të kundërshtarëvet!

Italia po rëshqiste buzë greminës! Dukej sikur urrente, para së gjithash, ushtarët e saj, fitimtarët e luftës, ata që vojtën për të gjithë, dhe q'u këthyen vetëm me pasurin e dekoratave të fituara në fushat e betejave. Ata pra që luftuan për madhërin e Atdheut, shaheshin, pështyheshin, përbuzeshin, edhe vriteshin. Socializma dhe bollçevizma e kishin katandisur vëndin në anarkinë më të dukëshme.

Më tërë anët çkatërim.

Grevat e pa sosura, më s'bëheshin tani për arësye profesionale, ato, kundërmonin përkundrazi, kryengritjen; zbërthenin n'atentate, në vjedhje, në vrasje. Të pazotë, të llahtarur, të dehur, drejtonjësit e kuq të punëtorëve turbullojnë ujrat që të mundin të peshkojnë. Por, me gjith ato, janë të pafuqishmë të ngrihen, të marin fuqinë me anë të zgjedhjeve, në pamundësi t'a marin me anë të forcës se nuk e ndejnë vehten të zotë. Socializma italiane, nuk bën tjetër veç se të çlirojë dizertorët e luftës: si rezultat të turbullimeve që shkakëton, nuk ka gjë tjetër përveç se anarkisë së përgjithëshme; është arritur në një mish-mash, në një vullnet të keq, në ligësira, në turbullime ku "as qeni s'mer vesh të zonë".

Të gjitha këto ishin shkake të mira për turbullonjësit. Por edhe sjellja e dobët e Aleatëve në Versailles, q'e kishin kobuar Italinë, i kish dëshpëruar italianët me plot arësye; lodhjet e sakrificat e luftës së gjatë, çregullimi moral, mundimi i madh që kish bërë populli, dobësimi ekonomik dhe politik i Shtetit, varfëria e njerësve që filloi të ndjehej, ishin raste të bukur për spekulonjësit marxistë. Ata arrinin të mohojnë edhe vlerat ideale të racës.

Në mes të kësaj gjendjeje kaotike, drejtori i fletores "Il Popolo d' Italia", është i vetmi burrë, midis njerësve të

politikës që s'gabohet e që s'tundet. Ay ka besim në forcat e pathyera, të vërteta, të gjalla të fisit.

Duke u radhitur nga ana e luftës, duke luftuar në luftë, ay kish luftuar për revolucionin, nuk mund të qëndronte me duar kryq, se “ne nuk jemi dhe as që duam të jemi mumje të ngurrosura përjetësisht, me fytyrën gjithnjë të këthyer në një horizont të vetëm, por edhe as që duam të mbyllemi në kufit e ngushta t'adhurimit të tepëruar shktrimtar, ku përsëriten mekanikisht formula të njëjta me lutjet e feve të profesuara; por ne jemi burra, dhe burra të gjallë, që duam të sjellim kontributin t'onë, sado modest qoftë, për krijimin e historisë”, shkruante ay më 15 Nëntor 1915.

Dhe q'atëhere kish lajmëruar se një botë e tërë do të perëndonte, se liberalizma, individualizma dhe kapitalizma do të shkrumboseshin në luftë, do të digjeshin edhe idhujt e tyre aqë tepër t'adhuruar, do të çkatroheshin të gjitha kështjellat e tyre ëndarake. Lufta vetëm do t'a hapte udhën e revolucionit.

Por lufta që është milicie, dishiplinë, është edhe luftim për tërë Kombin. Kështu zenë vënd në gjenin e Mussolini-t, të dyja themat më kryesore të kohës: problemi kombëtar dhe problemi shoqëror. Dhe përveç Tija s'ndodhesh burrë t'atër që t'i pajtonte në vet-vete këta dy probleme. Tani Burri i madh i shekullit, kishte para tij një fushë të gjërë për të punuar, një udhë të gjatë për t'ecur dhe me vehte sillte eksperiencën vetiake për t'a vënë në provë: përmbi këto vullnetin e tij për t'i realizuar. Vullneti e sundonte jo ndonjë doktrinë, s'kish menduar ala në doktrinën.

Po vullneti për të udhëhequr popullin italian, t'a shpëtojë nga rreziku, t'a shpjerë drejt një rendi të ri, rend

që gjeniu i tij kish parashëkuar, a nuk ish një program, një doktrinë? Vërtet i pa shkrojtur mbi letër, më ngeh, në kënaqësin e tryezës me kultukët e butë, por program e doktrinë realiste sepse përpara se të jet i ‘tillë është veprim: “për ne fashistët, jeta është një luft’ e vazhduarshme dhe e pasosur, të cilën e pranojmë me një qetësi të madhe, me një kurrajë të madhe, me trimërin e nevojshme”, do të shkruajë ay më vonë.

Luftë pra edhe tani, si në kohën e ndërhyrjes, Mussolini ngrihet dhe mbruan fitorjen, mbruan luftën, mbruan të gjitha të mirat q’ ajo sillte, mbruan të gjitha mundësit e saj pa përjashtim. Dhe u drejtohet po atyre njerëzve që I vanë pas më 1915, se vëtëm atyre u përkiste të caktojnë vijat e rendit të ri politik e shoqëror.

Këta njerëz që Mussolini skaliti duke u dhënë dhe frymën e shpirtit të tij të madh, ishin italianët e stërvitur nga eksperiencia katërvjeçore e një lufte të zorshme. T’asaj lufte që kish pasur karakterin e dyfijëshme revolucionar. Ajo me të vërtet e vuri popullin përballë një nevoje historike duke i dhënë kështu ndjenjën e tërësis së tij. “Lufta jonë ka qënë një luftë populli! Fitorja është fitorje populli! Ka qënë një goditje e tmerëshme midis forcave të së shkuarës dhe atyre të së ardhmes.”

Fashizmi nuk mund t’a pranojë pacifizmin që fsheh një frikë dhe një poshtërsi përballë luftës, “vetëm lufta i ngreh në kulmin e çvillimit të gjitha energjit njerzore dhe u vulos një shënjë fisnikërie popujve që kanë kurrajën t’a përballin. Të gjitha provat e tjera nuk janë veç se të radhës së dytë dhe nuk e venë kurrë njerinë përpara vehtes së tij, n’ alternativën e jetës e të vdekjes”.

Me gjith pjesëmarjen e shumicave të mbëdha, lufta tregoi vlerën e individit, veprimin e pa-zëvendësuarshme

vehtësor, guximtar, të jashtzakonëshmë. “Të vlerësohet individi. Të mos frenohen të guximshmit. Të mos lihet gjë pa u provuar. Të mos para vlerësohen kriteret shtetërorë të burokracisë, mbi impulset dinamike t’individëve.

Duhet të përcaktohet “a priori” kjo e vërtetë: s’ka gjë të pamundur! Veprimi është më i pëlqyer nga përcaktimet e këshilluar nëpër librat. Veprimi i çkallmon hekurat mbi të cilat është shkrojtur “ndalohet hyrja”... Të lënë të qëndrojnë, të guximshmit sulmojnë dhe dërmojnë pengesën”. Kështu shprehej Duce-ja më 1918 me rastin e një ndërmarjeje legjendare të një grupi fashistësh.

Duke rivendikuar për vehte dhe për shokët e luftës, të drejtën dhe detyrën të mbrujë luftën dhe fitorjen, Benito Mussolini, kërkon t’i japë Italisë dhe jetës italiane, një ideal të frymëzuar nga interventizmi, nga lavdia e fitores. Sepse Rivolucioni fashist kishte filluar pikërisht që në kohën e ndërhyrjes, kish vazhduar tërë kohën e luftës dhe tani dëshëron t’a zbatojë. Kështu do të fillojë një politikë e re, politika e shumicave. Kështu fillojnë përpjekjet e goditjet midis fashistëve dhe marxistëve, mohonjësve t’Atdheut. Lufta është e pamëshirëshme.

Më 23 Mars 1919, Duce-ja thiri në Milano, në mbledhjen historike të Sheshit San Sepolcro, një grup kameratësh nga tërë anët e Italisë, gati të besojnë bashkë me t’ë dhe gati sidomos të zbresin edhe një herë më shumë në fushë, për të shpëtuar Italinë që po rëshqiste në greminë. Kështu u krijuan Fashet Italianë të Luftimit. Q’atë ditë dhe me atë grup burrash, filloi ajo vepra titanike e ndërtimit dhe e qytetërimit fashist.

## SKUADRIZMA

Pas themelimit të Fasheve Italianë të Luftimit, në Milano, në mbledhjen historike të Sheshit San Sepolcro, programi i veprimit, paraqitur nga Kryetari, u-aprovua me entuziazmë.

Të gjithë pjesëmarësit u-betuan t'organizojnë luftimin kundra mohonjësve t'Atdheut me anë të skuadrave sulmonjëse në çdo kënd t'Italisë: gati për çdo guxim dhe për çdo sakrificë.

N'atë program përmbledhesh edhe ekzaltimi i vlerës, i therorisë si dhe vullneti për t'iu kundërshtuar imperializmit të Shteteve që deshën të dëmtojnë Italinë; ndihma që duhej t'i jepej ndërmarjes së shkëlqyer fiumane të D'Annunzio-s; parashëkimi i një Shteti me bazë organizatash sindakale të prodhonjësve dhe me përfaqësimin e punëtorëve n'organet e Shtetit.

Lufta që Mussolini kish filluar, vazhdonte e hapur kundra liberalizmës, demokracisë, parlamentarizmës, masonerisë dhe tërë karvanit socialo-bolçevik; kundra pazotësisë së klasave drejtonjëse.

Ay, kish besimin më të plotë nër pakicat e guximshime që në mes të turmave kaotike merrnin një karakter krejtësisht të çquar. Brënda pak muajve, me qindra Fashe, u krijuan kudo, përveç atyre që formoheshin jashtë Shtetit. Çdo Fash kishte një ose më shumë skuadra luftimi. Përhapen ato thirjet dhe zakonet ushtarake që arrijnë të puthiten me një herë me Fashizmin. Përhapet mbajtja e këmishës së zezë, element kryesor i uniformës së fashistit.

Përhapej edhe ndjenja e thellë e e veprimit e frymëzuar nga spirita e lartër e Mussolini-t. Një shtytje e



naturëshme, mistike, fetare vlon në zëmrat e të rinjëve q' i vinin pas. Kjo rini me veprimin e saj, do t'a gjallërojë lëvizjen fashiste që në fillim. Spirita e tyre vetëm mund t'a shpjegojë sulmin me të cilën të rinjtë shkollarë, punëtorë, fusharakë, vrapojnë të radhiten nën Shenjat e Liktorit. Fjala e Kryetarit, nuk ishte nga ato që premtojnë vetëm kënaqësira, suksese e gëzime, ajo përkundrazi, kërkonte përpjekje luftim e dishiplinë të çeliktë. Ky korent besimi mistik që frymëzonte pjesmarësit e parë të lëvizjes, dukej tani të pushtojë tërë Italinë, kështu që, pas një kohe të shkurtër, të pakat duzina të pjesmarësve në Sheshin San Sepolcro, arrijnë qindëra mijë, të gjithë të lartësuar nga e njëjta frymë: gati për të luftuar, gati për çdo therori.

Koha që rodhi prej vitit 1919 e gjer më 1922, ka qënë një periudhë ngadhënjimi dhe celebrimi t'asaj fitorjes së Vittorio Veneto-s, por që nga faji i mohonjësve t' Atdheut, kishte qënë e kobuar nga aleatët, mjerisht sakrificave të mëdha që kish bërë Italia gjatë luftës fitimtare.

Veprimi i skuadrave, në gjith qytetet e fushat, ka qënë veprimi i një djalërie të lartësuar nga mistika e Shefit të tyre, që luftonte pa urrejtje as mëri turbullonjësit dhe profetët batallë. E përballonte turmën kundërshtare jo me inatin t'a çfarosë, por nga dashuria t'a ngrerë lart, t'a sjellë n' udhën e drejtë.

Arsyeja e Mussolini-t, e këtij çkatëronjësi të një regjimi dhe një klase drejtonjëse - më mirë të themi të një epoke të tërë - nuk ka qënë të çkatëruërit më të kotë, se nuk ka çdukur asnjë vlerë të gjallë; Ay ka pasuar përherë ndërgjegjen e lartë, t'a lerë pemën të japë frutin e saj: ekuilibri i gjeniut të tij është i shëndoshë dhe i patundëshmë.

Të vrarët fashistë, që vdisnin me pushkë në dorë në luftimin e ndershëm e të hapur kundra një kundërshtari q' ish pors i një bishë e jo si njeri, ishin ushtarë dhe ushtarë trima, ushtarë të një besimi, vërtet fare të ri, por për të cilin ishte tepër e këndshme të luftohej dhe të vdisej. Stili i skuadristëve, dishiplina e tyre, shkathtësia në luftim, pranimi i sakrificës dhe i vdekjes qenë një mësim i lartër për popullin dhe sidomos për të rinjtë se, “asnjë ideal s’ka qënë, si ay i fashistit, i konsakruar me gjakun e aqë të rinjvet”, do të thotë Duce-ja më vonë.

Në zgjedhjet politike të 1919, kandidatët e Fashit patnë suksese shumë të vegjël, kurse socialistët dhe popullorët, mbushin Dhomën me deputetët e tyre; por edhe numri i fashistëve atëhere nuk i kisht kaluar të 10.000. Por me gjith që të pakët, fashistët shkonin përpara: vepronin e sulmonin.

Në Milano, një kollonë e gjatë prej 10.000 “kuqalashësh” po drejtohej për në qëndrën e qytetit pasi kish organizuar një manifestim. Përpara këtij ofendimi, një grup i vogël fashistës, t’ armatosur me kopaçe dhe revole, iu – vërsul manifestojëve dhe i shpërnda. Po atë ditë, fashistët sulmonin, duke u-vënë zjarrë, zyrave të fletores socialiste “Avanti!” Q’atëherë filloi të derdhet gjaku i parë, q’ atëherë filluan hjenë në luftim e sipër martirët e fashizmit.

Por tanimë, lëvizja fashiste ish përhapur në tërë këndet e Italisë dhe kështu u-formua skuadrizma e cila më vonë do t’ arrijë forcë milicie. Ndërkohë kundërshtarët kanë organizuar “rojet e kuqe” që përbëhen nga dizertorët e luftës, nga neutralistët dhe nga njerëz që e kishin kaluar periudhën luftarake të fshehur; nga njerëz që s’ mundnin e as e kishin ndjerë kurë pasionin dhe bukurinë e saj. Por

në luftën e përditshme e të palodhur, fashizmi mbyti grevat dhe përforcohet. Në shumë nga krahinat rëmben fuqinë duke dbuar të kuqtë dhe autoritetet Shtetërore, në pazotësi të venë në zbatim ligjet. Kabinetet ministrorë rrukullisen njëi pas tjetrit; rrëzohet kabineti i Orlandos që s' mundi të mbraujë interes Italianë në tryezën e çalët të paqes dhe vëndin e tij e zë ay i Nitti-t; Qeveria e Golitti-t, kalon nga një dobësi në një tjetër. Më tërë anët vazhdojnë zaptimet e fabrikave nga punëtorët; kudo greva, violence, anarki. Shteti vazhdon të jetë i pazotë t' imponojë bindjen. Më 12 Shtator 1920, D' Annunzio okuponte Fiume-n dhe pritej atje me entuziazmin e popullit, i cili, me armë në dorë, ishte ngritur të mbraujë italianitetin e vetë.

Ky okupacion ishte një hap i dytë drejt rilindjes së Kombit. Ishte njëkohësisht edhe një dackë për Evropën anti-italiane, dackë kundër intrigave të demokracisë e dhënë nga një grusht trimash të rinj plot besim e kurrajë. Për të rinjtë ajo ndërmarrje arriti rasti i parë në të cilin ndjenë atmosferën e luftimit. Gjestin e shkëlqyer të Komandantit n' Itali e përkrahte me mish e me shpirt vetëm Mussolini e fashistët e tij, të tjerët e kundërshtonin.

Përballë rilindjes së spiritës kombëtare që kish mbledhur redh saj, tërë popullin, socialistët dhe neutralistët zunë të tmerohen, zunë t' alarmohen për reaksion. Përpiqen të formojnë një front të përbashkët anti-fashist dhe me një herë fillojnë me violencat më të këqija. Mirëpo, Fashizmi, s'ish reaksion por Rivolucion; ishte diçka e veçka e veçantë që s'u- përngjiste aspak tjerëve.

Ay s'ishte as parti politike, në kuptimin e vjetëruar të fjalës, ishte lëvizje. Ay e kuptonte t'ardhmen e Italisë në bazë t' eksperiencës së luftës të luftuar dhe kish me vehte,

përveç ish-luftëtarëve edhe të rinjtë që ishin ritur duke pritur orë të tëra rëmbejnë pushkët. Ata të rinj, zemrat e të cilëve mund të entuziazeshin, që mund të praninin çdo sakrificë sado e madhe t'ishte që përbuznin doktrinat politike të cilat veçse të predikojnë filosofin e materializmit, nuk ishin të zonjët për gjë tjetër. Socialistët deklarorin tani se do t' a mernin fuqinë me çdo mënyrë edhe me anë të forcës.

Ishin të shumta komunet që administroheshin prej tyre e që ngrinin mbi çatitë flamurin e kuq. Në disa vënde, dhomat e punës bënin zullumet më të këqija antikombëtare. Automietet, nuk mund të qarkullonin veçse me lejen e tyre. Terorizma kish arritur sistemi i tyre. Në shkurtin e vitit 1921 ata hidhnin një bombë në sallën e theatros Diana të Milano-s, gjatë një shfaqjeje, duke shkaktuar shumë të vrarë e duke ngjallur urrejtjen e përgjithëshme.

Nuk është nevoja të zgjatemi mbi imboskatat tradhtore që u bëheshin fashistëve dhe vrasjet e tyre nga ana e anti- kombasvet. Po fashizmi forcohej përherë e më shumë dhe dinte kudo, t' a zëvendësonte Shtetin e falimentuar. Zgjedhjet e vitit 1921, shpjenë në Dhomë deputetët e parë fashistë. Në parlamentin e vjetëruar, fillon të tingëllojë ora e fundit të tij. Deputetët fashistë dbojnë me shqelma deputetët dizertorë. Fashet e Luftimit kthehen në një Parti krejt të veçantë nga të tjerat, në një parti të vërtetë politike.

Edhe një vit përpjekjesh akoma dhe Fashat e Luftimit do te llozin një rol kryesor në tërë Italinë, do të kenë një fuqi aq të madhe sa të mundin, dal nga dal, t' u venë fshesën të gjitha partive politike të shkatrimit kombëtar. Eksperienca e luftës dhe e pas-luftës, kishin krijuar një

doktrinë politike e një stil veprimi krejtësisht fashist. Lëvizja, që kish qëndruar në muajt e parë larg theorive politike zbërthen në një organizim të gjërë të ngatruar, por të çquar fare mirë, nga gjith partit e tendencat e të tjerëvet.

Ajo ecte tani drejt ngadhnimit të Shtetit. Dhe kështu 60.000 burra në regull marshimi do të lëshoheshin drejt Romë-s, për t'i siguruar Italisë madhështin e s'ardhmes së saj të lavdishme.

## MARSHIMI MBI ROMË

Skuadristët, ata militantët e një ideali më të lartër, ideali i përbërë prej një veprimi dhe një poezie, të një ideali ndriçonjës që ka kuptimin dhe gjykimin e vullnetit; ajo djalëri që përfytyronte jetën në çshvillim, në kundërshtim me pleqërinë që varei akoma e dëshpëruar mbi të shkuarën, eci me guxim pa njohur asnjë pengesë, pa marë parasysh asnjë rrezik dhe në luftimet e saj, në përpjekjet e veta i njoiti të gjitha rastet e pasionit të pakufishmë, me anën e të cilëve pastaj, Italia, mundi të pastrohet, të përtërihet dhe të rifitojë cilësitë e saj të moçme.

Skuadrizma një mrekulli e gjallë, një shprehje e zjarrtë që çfaqet mbi skenën italiane; skuadrizma me tributin e gjakut të saj do të përgatitë shpëtimin dhe do t'u japë dhe burracakëve shëllëmbën e shkëlqyer për mospërfilljen e rrezikut, shëmbëll që tanimë, ka arritur mënyrë jetese për tërë popullin; burrim i pashterur shëmbëllash për botën e tërë.

Skuadristëve as vullneti për të jetuar nuk u'andalonte dëshirën e flagtë për therorin më të madhe. Ata e kërkonin armikun kudo që ndodhej dh' e përballonin me guxim;

përbuznin me urrejtje ëndjen kllanike dhe sa m'i madh t'ish rreziku, aq m'i tepërt guximi; sa m'i shumtë t'ish kundërshtari, aq m'i lartër nderi; me buzëqeshje trimërore, mbi plagët e mara, e mbi leckën e lidhur mbi to ata shkruanin fjalët; “me ne frengo” se “për fashistët burimi i të gjitha gjëravet është forca e amëshuar e shpirtës”.

Ishin këngë luftarake dhe britma entuziazmi ato që dilnin nga gjokset e tyre: Rroftë Italia! Çdo gjë që s'i përkiste Italisë së tyre, ish kundra tyre. Kapnin bufërit e Internacionales: u qethnin leshrat e kokës dhe u-pikturonin mbi to tringjyrëshin. Për barkalecët e ngjallur demoplutokratë, një shishe vaj recine. Për kokëshinikët antikombëtarë, disa silla manganelloje.

“Me kurrajën e tyre i dhanë një impuls të fuqishmë rrotës s' historisë.” Ish një mot me shumë rëndësi, ay i 1921-së. Për hapjen e lëvizjes fashiste, sqarimi i pozitës së saj përballë problemeve themelore të politikës së brëndshme dhe të politikës së jashtme, e kthyen lëvizjen në Parti.

Mussolini mund të proklamonte, patjatër se Fashizmi, “mobilizim i madh forcash morale dhe lëndore“, kish ndërmënd “të qeverisë Kombin” për t'a bërë Italinë të madhe dhe të begatshme: për këtë kish vënë në lëvizje vlerat morale dhe tradicionale. Ay do t'i japë Italisë një Shtet, që i mungon, por një Shtet të fortë, t' a bëjë Italinë të fortë, të fortë edhe në fushën ndërkombëtare.

Pas pakë muajve Italia do të jetë me të dy fjalët Fashizmë-Itali një gjë e vetëme. Të gjitha shprehjet, të gjitha përpjekjet vëzhgojnë një pikë të caktuar: Shtetin. Se çdo politikë që ka me të vërtet besim në qëllimet e veta,

dëshëron t'arrijë gjëndjen e bukur të kurrorëzimit t'idealit, t'arrijë në gjëndje të qeverisë. Në se partit e së mëngjërës, n'Itali, nuk guxuan të marrin përgjigjësën e të qeverisurit për t'a këthyer kështu, përmbajtjen e doktrinës së tyre në Shtet, është për arsye se ata, mjerisht forcave që dispononin, nuk kishin besim n'atë përmbajtje, nuk ishin të sigurt të vet-vetes.

Përkundrazi, Fashizmi, shprehje energjike dhe tërësore e një çasti historik, pohoi që në fillim të themelimit të tij vullnetin e patundur të këthehet në një realitet juridik më tepër sesa politik dhe për këtë u-pregatit në mënyrë që, posa t'i mundej, të merte vet drejtimin e Shtetit. Prandaj filloi me kohë një lëvizje mendore, një rahje idesh; botohen fletore të shumta fashiste.

Në Milano del revista Gerarchia, titull plot kuptim dhe drejtor: Mussolini. "Il Popolo d'i Italia" nis një sërë bisedash, ku tërë intelektualët e Fashizmit sjellin kontributin e tyre mendor. Rihen me radhë tërë problemet e çastit por sidomos ata të s'ë ardhmes. Problema që rjedhin vetiu nga çvillimi që ka marë Fashizmi.

Fashizmi dhe Shteti; Fashizmi dhe Politika e Jashtme; rikqyrja e trakteve; lufta kundër demoplutokracisë; çvillimi i forcave prodhonyjëse, etj, se "s'ka dyshim që Fashizmë dhe Shtet janë caktuar, mbase në një kohë relativisht t; afërme, t' arrijnë një gjë të vetëme. Fashizmi mund t'a hapë portën me kyçin ligjor, por mund edhe të jet' i shtrënguar t'a çkyejë portën me një sëllem shpatullash kryengritje".

Fashizmi ka arritur një organizm' e madhe, e plotë, gjerarqike. Me të vërtet, kur u-mblodh kongresi i Romës, më 7 Nëntor 1921, kish reth tij një shumicë dërmonjësore përfaqësirash t'erdhura nga tërë anët e Italisë. Kurse në

Kongresin e Firnces të vitit 1919 ishin përfaqësuar vetëm 200 Fashe, dhe 17.000 të regjistruar, në këtë të Romës, Fashet arrijnë numurin 2200 dhe anëtarët kalojnë të 300.000. Në vitin 1921, Fashizmi, nga rrethet e ngushta të disa qendrave zgjerohet nëpër krahinat e nëpër fushat, arrin një lëvizje turmash. Regullohet organizimi ushtarak dhe ay sindikal përkrah atij politik: fashe, skuadra, sindikate. Fashat e sindikatet shkrihen në Federata me baza krahinore.

Në këtë vit Fashizmi shkon në Parlament dhe proklamon t'a bëjë Romën, qëndrën e tij në vend të Milano-s: "Le t'a shpiem pra, me shpirtin e kulluar q'është një nga të pakët qytete të shpirtës që gjenden në botë... Ne mendojmë t'a bëjmë Romën qytetin e spiritës s'onë, një qytet domëthënë të pastruar, të dizinfektuar në tërë elementët q'ë e korrumpojnë dhe e ndyjnë, mendojmë t'a bëjmë Romën zemrën pulsante, shpirtën e gjallë t'Italisë perandorake që ne ëndërojmë". Roma, ku do të bëhet një hasje ideale me Monarkinë dhe me Papatin; Romë, kjo fjalë jehon përherë më shumë në grumbujt e fashistëve; Romë tingëllon mrekullisht: autoritet, botërim, perandori.

Në kongresin q'u mbajt në qytetin e amëshuar, u-vendos transferimi i Drejtoris së Partisë, dhe kjo u krye më vonë. U-vendos gjithashtu që 21 prilli, datë e themelimit të Romës, të jetë festë fashiste, të jetë festa e punës. Aty u-muar vendimi që lëvizja fashiste të këthehet tanimë, në Parti.

E kthimi në Parti kish kuptimin e një njësimi më të plotë, të një sigurimi më të madh. Viti 1922, është viti i kryengritjes. Tani asgjë nuk mund t'u përballet forcave të Fashizmit. Çasti i sulmit të madh po afrohet. Në Bolzano,



Këmishët e Zeza kishin dhënë provën më të ndritur, përveç ndjenjës dhe kuptimit të thellë redh problemeve konkretë të qeverisë, t'organizimit ushtarak dhe të mundësis të përshtatin me të shpejtë përqëndrimin e forcave të tyre. Marshimi mbi Romë, i vendosur më 16 Tetor në një kuvend të Milano-s, u provua në mënyrë të përsosur nga zotësia organizonjëse e kuadrove të Fashizmit, të dishiplinës si dhe të ndërgjegjes ushtarake të gregarëvet.

Në mbledhjen e madhe të Napoli-t, më 24 Tetor 1922, 40.000 fashistë dhe 20.000 punëtorë në fundin e fjalimit të fuqishëm të Mussolini-t, bërtitën njëzëri; në Romë! në Romë! Dhe Duce-ja u përgjigj: “Është një çështje ditësh, mbase dhe orësh”. Fashizmi nuk do t'ecë kundër Romës, ay do të shkojë drejt Romës në emër të Romës. Ay nuk kanos Monarkinë, përkundrazi i drejtohet arbitrazhit të saj duke i këthyer edhe funksionin sovran. Kollonat fashiste do të marin drejtimin e kryeqytetit të ndarë më trish, më një mijë këngë lufte e duke thirur: Rroftë Mbreti. Mobilizimi i përgjithëshëm i ushtrisë fashiste u shpall në tërë Italinë më 27 Tetor 1922 dhe natën filloi lëvizja e Këmishave të Zeza t'armatosura me çdo lloj pushkësh.

Brënda disa orëve e tërë Italia veriore dhe qendrore ishin në duart e fashistëvet. Komanda e përgjithëshme e ushtëris fashiste qëndronte në Perugia dhe përbëhej nga Kuadrumvirët: Emilio De Bono, Italo Balbo, Cesare De Vecchi dhe Michele Bianchi. Mussolini që ndodhej në Milano priste çvillimet e veprimit. Forcat fashiste të nisura nga Perugia muar drejtimin e kryeqytetit, kur

Qeveria e kryesuar nga Facta, përfaqsonjëse e parlamentarizmës - i propozonte Mbretit shpalljen e shtet rethimit dhe shtypjen e marshimit fashist me anë të forcës

ushtarake. Por Madhëria e Tij refuzoi të firmojë atë dekret sepse Ay e dinte mirë se pas kujt shkonte populli: pranoi dorëheqjen e Facta-s dhe të nesërmet më 29 tetor ftonte Benito Mussolini-n të formojë një Qeveri të re. Më 20 tetor, Duce-ja arrin në Romë.

Udhëtimi i tij gjer në kryeqytet ish ngadhnimtar. Midis një mizërie në kulm t'entuziazmit, të përmbajtur më të dy anët e rrugës nga skuadrat fashiste, i veshur me Këmishën e Zezë, ay drejtohej nga Quirinale. 50.000 njerëz parakalojnë me Mussolini-n në krye, para balkonit ku, Madhëria e Tij Mbreti i Italisë, qëndron midis Mareshalit Diaz dhe Amiralit Thaon di Ravel, të cilët kishin komanduar, i pari ushtrinë dhe i dyti flotën, kur lufta mori fund në Vittorio Veneto.

“Po i sjell Madhëris s’Uaj Italin e re, Italin’ e Vittorio Veneto-s të rikonsakruar nga fitoret e reja”.